



## PROCESVERBALI

Mbledhja e katërt (4) e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më 05.07.2022 me fillim në ora 15.30. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës Smajl Latifi: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

**Kryetari**- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë anëtarët e KKSB, përshëndes nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e tretë e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpara e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2022 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

### Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
  - Prishja e rendit publik nga lokalet e natës dhe personat e pandërgjegjshëm,
  - Masat e parandalimit të lëmosh kërkuesve,
  - Planit operativ për sezonin e pushimit të bashkatdhetarëve tanë dhe dasmave,
  - Siguria në Trafik,
  - Parandalimi i keqpërdorimit dhe kursimi i ujit të pijshëm;
  - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror;
  - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
  - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,
3. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë dhe promovimin e bashkëpunimit ndëretnik, ndërfetarë dhe multi – kulturor.
4. Të ndryshme.

**Kryetari** - A ka dikush të shtoj diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë po e vendosim në votim. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

**2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit.**

Të gjitha nën pikat që janë të ndërlidhura me pikën e dytë të rendit të ditës, besoj se janë edhe të nevojshme por edhe të arsyeshme që të diskutohen në këtë takim. Ne të gjithë jemi dëshmitar që ka tentime

për prishje të rendit publik, pastaj ka shkelje të ligjeve dhe vendimeve nga ana e lokaleve të natës. Poashtu kemi edhe nën pikat që lidhen me angazhimin tonë të përbashkët dhe futjen në funksion të të gjitha instrumenteve që i kemi në funksion sipas ligjit në mënyrë që të përqendrohemi në veprimet tona. Tani kemi rritje të temperaturave, ardhjen e bashkatdhetarëve tanë, kemi sezonin e dasmave dhe si pasojë e vapës së madhe ka mundësi që të kemi edhe shpërthim të zjarreve, poashtu e kemi një situatë që nuk e kemi pasur vitet e kaluara që është furnizimi me ujë të papijshëm, paralajmërohen reduktime nga ana e kompanisë Gjakova. Ne duhet të flasim diçka s ai përket parandalimit të ujit të pijshme, poashtu të ju njoftojmë edhe me infrastrukturën fizike të rrjetit të ujës-jellësit që janë të vendosura si në qytat ashtu edhe në zonat më të larta të qytetit. Tani jemi në sezonin e korrje shirjeve, ekziston mundësia që të bëhet djegia e hamulloreve dhe djegieve tjera edhe si pasojë e temperaturave të larta në këto ditë që i kemi, të gjitha këto mua më bie në një konkudim se siguria e përgjithshme dhe gjendja e përgjithshme e sigurisë në komunën e Rahovecit për momentin është e qetë dhe stabile përkundër faktit që i përmendem disa sfida. Para sa të ja japë fjalën komandantit të stacionit policor për këtë pikë, nëse ka dikush të shtoj diçka ose të jep ndonjë informatë të dobishme sa i përket kësaj pike dhe nënpikave që janë pjesë e kësaj pike fjala është e juaja, nëse jo fjala është e komandantit.

**Fazli Morina** – Përhëndetje për gjithë pjesëmarrësit në këtë mbledhje, do i cekim pikat më thelbësore në mënyrë që mos të ju marrë kohën edhe juve. Sa i përket situatës së sigurisë e cila është në zonën tonë të përgjegjësive vlerësohet që është e qetë dhe stabile, pa ndonjë indikacion për prishje të qetësisë dhe ndonjë incidenti të mundshëm. Sa i përket veprave penale të iniciuara gjatë kësaj periudhe, në stacionin policor në Rahovec gjithsej janë të regjistruara 49 raste vepra penale dhe 3 incidente jo penale, nga këto janë 8 vjedhje, ku vjedhje të rënda 11, dhuna në familje 5, armëmbajtje pa leje 1 rast. Siguria në komunikacionin rrugorë vazhdon të jetë jo e kënaqshme, sipas planit operativ të sigurisë së trafikut rrugor gjatë kësaj periudhe janë shqiptuar më pak gjoba sepse jemi me mungesë të personelit dhe kushteve të tjera logjistike, gjithsej janë 910 gjoba në trafik dhe 17 kundërvajtje të prishjes së rendit të qetësisë publike. Pasi tjetër operativ i cili ka të bëjë me sigurinë në trafik, lirimimi i hapësirave publike nga automjetet e paregjistruara të dëmtuara dhe parkingjet ilegale është plan vetëm për Rahovecin, gjatë kësaj Kohe vetëm në brendësi të Rahovecit janë shqiptuar 169 gjoba për parkingje dhe kundërvajtje tjera. Siguria në shkollë, edhe pse është e qetë dhe stabile, por rastet edhe kësaj radhe nuk kanë munguar, kemi të paraqitura 6 raste, një rast është keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në shkollën Selajdin Mullabazi – Mici, pastaj asgjësimi ose dëmtimi i pasurisë me paralelen e ndarë Mustaf Ibishi në Mrasor, kanosje me mjete shpërthyes ekspozive kemi pasur në dy shkollat e mesme të ulëta në lagjen Vuk Karaxhixh, poashtu edhe në shkollën e mesme të ulët Svetozar Markoviq në Hoçë të Madhe, kanë qenë dy paralajmërime të rreme, është bërë vend shikimi nga njësitet e specializuara. Pastaj kemi një vjedhje në shkollën e mesme Xhelal Hajda – Toni në Rahovec, ku është vjedhur një telefon gjatë testit të maturës, poashtu një vjedhje e rëndë në tentativë me 31.03.2022 në fshatin Gur i Kuq, kësaj radhe kemi shtuar edhe një tabelë me statistika ku siç e shihni është shqetësuese periudha është maj- qershor, gjatë muajit maj aksidente me dëme materiale kanë qenë 3, qershor 3, aksidente me dëme të lehta 7 në maj, 10 në qershor, aksidente me lëndime të rënda 1 në maj, 4 në qershor, aksidente me fatalitet maj 1, qershor nuk ka pasur. Persona të lënduar gjithsej majë 14, në qershor 16, persona të lënduar rëndë maj 1, qershor 4, me motoçikletë aksidente 2 në maj, 3 në muajin qershor. Këmbësor të koditur nga automjetet 3 në maj, 2 qershor, me mjete të punës 1 në maj dhe 1 në qershor dhe vetë aksident 2 në maj dhe 3 në qershor. Në total numri i aksidenteve dhe dëmeve materiale 6, aksidente të lehta 17, lëndime të rënda 5, me fatalitet 1, persona të lënduar 30, të lënduar rëndë 5, motoçikletë 5, këmbësor 5 dhe vetë aksident 5, këto janë për 2 muaj. Kaq kisha në pika të shkurta, nëse ka dikush të pyet diçka jam i gatshëm të ju përgjigjem.

**Vjollca Gergule** – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, kryetar faleminderit për të gjitha të mirat që jeni duke i bërë, flasë për të rinjtë e Rahovecit si dhe për sigurinë e tyre, këtë e bëjë sepse kur unë i përfaqësoj ata ndihem e sigurt sepse është dikush që i përgjigjet gjithmonë kërkesave tona. Kjo që do ta them ndoshta nuk ka lidhet shumë me ju por megjithatë unë e pash të arsyeshme që të jeni ju dhe anëtarët e KKSB-së në dijeni. Kërkesa ime i drejtohet komandantit të policisë, i nderuar ne më herët kemi pasur probleme me një grup të rinjsh të cilët janë të rebeluar, ku shpesh herë janë përlesh edhe me një pjesë të

stafit, ne nuk kemi ditur se si të reagojmë ta nëse i nxjerrshim jashtë ata bëheshin edhe më agresiv, nëse janë brenda rrezikohen të rinjët e tjerë që janë pjesë e SHL-Kosovës dhe pastaj ngurojnë të vazhdojnë aktivitetin. Nga kjo që e thash kisha pasur dëshirë një përgjigje nga komandanti se a do të ishte mirë që së paku 2 herë në javë policia e Kosovës të frekuentoj SHL-Kosovën që të jemi më të sigurve. E pash të arsyeshme që të ju njoftoj dhe çka do që mundet të bëhet në këtë drejtim do na kishte ndihmuar shumë. Kryetar ju e dini se në kemi pasur një kërkesë për vendosjen e konave rreth rugës, por ato janë thyer brenda natës, ju kisha lutur edhe një herë që në bazë të mundësive që i keni të shikoni mundësin dhe të vendosen përsëri nga pjesa e shkollës Xhelal Hajda – Toni dhe deri tek përfundimi i SHL-Kosova.

**Fazli Morina** – Fillimisht e nderuara z.Vjollcë nuk kam ndonjë njohuri që dikush ka raportuar një rast të tillë, është obligim qytetar që të raportoj për cilindo problem e leje më kur ka të bëjë me ndonjë shoqatë. Mirë kishte me qenë nëse na kishit informuar me kohë gjithashtu as ma mirë kishte me qenë nëse i njeh dikush ata njerëz dhe na kishin ndihmuar ne dhe vetvetes, ne nuk mundemi të shohim gjithçka, prandaj i mirëpresim informatat e juaja çfarëdo që na i sillni janë të mirëseardhura për ne. Mbështetje dhe dalja në vend ngjarje nuk do të mungojë edhe pse ne kemi patrullime më të shpeshta atje këtë e them me keqardhje sepse ka kërkesa shumë, por është e pamundur të plotësohen të gjitha këtë kërkesa, ne jemi duke bërë maksimumin e mundshëm.

**Kujtim Dina** – Përshëndetje të nderuar anëtar të KKSB-së, në bazë të përvojave të cilat i kemi pasur në vitet e kaluara dhe gjasave reale që mund të përballemi me temperatura të larta gjatë periudhës korrik-shtator ku mund të kemi zjarre fushore-malore në numër më të madh, ne si drejtori për mbrojtje dhe shpëtim i kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme sa i përket mjeteve dhe pajisjeve teknike për intervenim. Në gjendje gatishmërie i kemi pesë kamionë për zjarrfikës, tre automjete tjera për intervenim si dhe pajisje tjera të nevojshme për punë. Në rast të ngritjes së gatishmërisë emergjente dhe shpalljes së mobilizimit nga ana e kryetarit të komunës për njësinë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, atëherë do të kujdestarojmë me dy ndërrime nga 24orë vetëm që të jemi më efikas dhe t'i përgjigjemi thirrjes së qytetarëve. Në bashkëpunim me drejtorinë e bujqësisë do e risim kontrollën në sipërfaqe të pyjeve që i posedon komuna jonë, këtu si faktor kryesor do të ishte angazhimi i punëtorëve shtesë në terren për vëzhgim dhe parandalim të shpërthimit të zjarrit në periudhën korrik-shtator. Në kuadër të vetëdijesimit të qytetarëve për parandalimin e zjarreve fushore-malore dhe çdo lloj tjetër të zjarrit, si çdo vit tjetër edhe këtë vit do të kemi fushatë sensibilizuese ku do të shpërndajmë fletushka nëpër të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, në zyrët e vendit dhe në vendet më të frekuentuara nga qytetarët, këto fletushka shpjegojnë mënyrën se si të parandalojmë përhapjen e zjarrit si dhe mënyrën e lehtë të fikjes së zjarrit në rast se zjarri është me përmasa të vogla.

**Kryetari** – Ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhanë në pikën e dytë, sa i përket pyetjeve dhe kërkesave që i parashtror Vjollca, këtu ne i kemi evidentuar disa çështje të cilat besoj se janë shumë të rëndësishme që të nxirën përfundime sa i përket pikës së dytë. Besoj se anëtarët e KKSB-së e kanë të qartë se lokalet e natës nuk funksionojnë në komunën e Rahovecit pas orës 23:00 dhe për këtë çështje ka pasur një veprim të kombinuar të policisë, inspektoratit komunal, njësiteve të veçanta të policisë dhe inspektorëve sanitar. Qëndrimi është i qartë ka vendim, ne nuk do të lejojmë që lokalet e natës të vazhdojnë veprimtarin pas orës 23:00. Ne nuk kemi pasur ndonjë problem me ndërprerjen e këtyre veprimtarive të paarsyeshme të cilat sjellin më shumë probleme se sa dobi, besoj që nuk do të kemi as në të ardhmen, falënderoj të gjitha ata që i ceka më parë të cilët kanë marrë pjesë në zbatimin e ligjit. Sa i përket sallave të dasmave, lusë të gjitha ata pronarë të hoteleve që të aplikojnë që të marrin taksat shtesë sa i përket zgjatjes së orarit pas orës 23:00, këtyre i lejohet veprimtaria edhe pas këtij orari. Sa i përket qeneve endacak, këtë problem nuk e ka vetëm komuna jonë, pavarësisht që ka njerëz që ne mendojmë që nuk janë të informuar sa duhet dhe mendojnë se komuna jonë është përgjegjëse që ka qenë qen endacak në Republikën e Kosovës. Komuna e Prishtinës është e vetmja komuna e cila ka provuar që të zgjidhë këtë problem, por një komunë e vetme nuk mundet ta e zgjidhë këtë problem kaq të madh. Shteti jonë ende nuk ka mbërrirë që të jep zgjidhje kësaj problematike, ne si komunë vitin e kaluar i kemi trajtuar rreth 300 qen, por tash ndoshta numri i tyre është 3000, edhe nëse i trajton krejt 3000 çka pas 6 muaj, nëse këto qenë nuk kanë pronar dhe strehimore përsëri ato shumohen. Lutja jonë është që edhe ju të jepni kontributin që a

kemi mundësi të bëjmë diçka për këtë fenomen që është goxha shqetësues. Sa i përket zjarreve, është e vërtet që ne nuk kemi shumë zjarre, por rreziku i shpërthimit të zjarreve ekziston posaçërisht tani kur është duke u korrur gruri. Shpresoj se askujt nuk i shkon mendja të bëjë ndonjë gjë e cila do të mundte të i shkaktoj djegien e grurit sepse kapacitetet tona do të jenë të pamjaftueshme që ta izolojnë gjithë atë zjarr që mundet ta kaplojë territorin tonë. Ne e kemi njësinë e zjarrfikësve mjaftë të organizuar, kanë bashkëpunim të mirë edhe me policin poashtu edhe me qytetarë shumë herë solidarizohen me ta, poashtu edhe me komunat fqinje. Ne i presim bashkatdhetarët tanë, do të ketë aktivitete kulturore, festive poashtu edhe aktivitete të cilat me siguri më të madhe kanë me krijua një ndjenjë që ata janë në vendin e tyre dhe në shpinë e tyre, ne do të kujdesemi që edhe shërbimet të jenë më të veçanta për ta, ku do të ketë sportel të veçantë për ta, parking të veçantë për ta falës dhe shumë aktivitete tjera. Pavarësisht kapaciteteve patrullat e policisë besoj se duhet të shtohen në disa arterie të cilat frekuentohen edhe nga automjetet edhe nga motoçikletat si dhe nga qytetarët e shumtë, poashtu duhet të patrullohen më shpesh edhe disa rrugë ku potencialisht munden të jenë vendet e përshtatshme për veprime keqberëse, janë disa vend enë Rahovec të këtij lloji dhe policia besoj se është në dijeni për ato. Patrullimi më i shpejtë nga ana e policisë do të ishte një masë më e rëndësishme në planin e sigurisë. Sa i përket alarmeve të rrejshme siç e etha edhe komandanti kanë qenë dy në shkollat tona, poashtu ka qenë një edhe në aeroportin ndërkombëtar Adem Jashari, prandaj kërkoj nga anëtarët e KKS-së pa dallim, të bëhet apel që mos me tentu ndokush që ta provoj forcën e organeve tona sepse edhe kjo paraqet masë administrative, mundet të jetë edhe vepër penale. Sa i takon koneve e nderuara Vjollcë, ne do të shikojmë mundësit që ti vendosim përsëri, por duhet të shikohet që mos të vendosen të plastikës sepse siç e thatë edhe ju po dëmtohen shumë lehtë. Kurse sa i përket vijave për kalim të këmbësoreve ne do të shikojmë edhe atë ta kryejmë, por mirë kishte me qenë që të na vije një kërkesë nga ana juaj për këto që i cekëm. Edhe një herë sa i përket reduktimit të ujit të pijes që në këtë kohë kompania KRU – Gjakova është duke paralajmëruar, ka gjasa që lagjja e epërme të preket më shumë, arsyet sipas tyre janë gypat e asbestit dhe infrastruktura e vjetër dhe kjo pamundëson që të furnizohet deri në destinacione të caktuara me ujë të pijes, pastaj si më kryesorja është edhe keqpërdorimi i ujit të pijes, kjo duhet të ndalet sepse rrezikohemi që mos të kemi ujë ti pijes.

Konkluzë - I bëjë thirrje qytetarëve të komunës së Rahovecit pa asnjë dallim që mos të keqpërdorin ujin e pijes në mënyrë që mos të kemi në kohë vape reduktime, të përdoret vetëm për qëllime të pijes e jo edhe për ujitje të kopshteve ose perimeve të ndryshme që i kanë nëpër kopshte të tyre. Sa i përket trotuareve e kem një kërkesë, komuna e Rahovecit vazhdon të jetë njëra ndër komunat e radha që nuk ka parking me pare, të gjitha janë pa asnjë pagesë falës, ne jemi dëshmitar të makinave të parkuara nëpër trotuare, e lusë edhe këtu komandantin e policisë që të kenë veprime pa kompromise për këtë që parkojnë veturat në trotuare. Nga Hotel Plaza deri tek udhëkryqi që të shpije në Xërxë nuk ke vend në trotuare, ka makina që janë gjatë të parkuara aty, kemi situata që bizneset e kanë uzurpuar trotuarin komplet, jo me mallra ushqimorë por me materiale tjera, por ju siguroj se në këtë pikë ne nuk do të lëshojmë pe.

Konkluzë - Trotuaret duhen të lirohen dhe do të lirohen shumë shpejtë sepse nuk bënë më të vazhdoj kështu, prandaj kërkoj nga policia dhe inspektorati të veprojnë edhe me gjoba në mënyrë që trotuaret të jenë të lira. Ju falënderoj shumë, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

### **3. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë dhe promovimin e bashkëpunimit ndëretnik, ndërfetarë dhe multi – kulturor.**

Do i them dy fjali rreth kësaj teme, të gjitha aktivitetet të cilat zhvillohen në një komunë të caktuar, në këtë rast në komunën tonë nuk e besoj se kanë të bëjnë me ndonjë përpjekje ose tentativë asaj që është reale. Ne e dimë në komunën tonë që shumica e madhe janë shqiptar, por ka edhe egjiptian, romë, ashkali dhe serb, ky është promovimi më i mirë në këtë mozaik dhe asnjëherë nuk e besoj që duhet të kemi probleme të natyrës ndëretnike, probleme të cilat kanë të bëjnë me aspektet kulturore edhe pse ka kultura të ndryshëm por ne jemi qytetar, por edhe bashkëpunimi ndër fetar, ndërkulturor dhe ndëretnik besoj se të gjitha janë të pranishme në komunën tonë dhe nuk ka arsye që dikush këtë ta sheh ndryshe sepse çdo tentativë që mundohet të sheh ndryshe është jo reale. Ne kemi pasur disa aktivitete sportive të përbashkëta që kanë dalë po nga kjo pikë, i ftojë kush ka mundësi që me 2,3 dhe 4 shtator të merë pjesë në Hardh Festë me ndonjë pije të mirë që e ka, këtu nuk ka përjashtime për askënd. Munden të parashihen poashtu edhe

aktivitete sportive, e mirëpresim edhe ndihmën e OSBE-së, si në futboll, basketboll krejt që është sportive, jam i pajtimit që ku dëshironi ju të zgjidhni vendin dhe kohën ne do jemi aty me ju. Ne e kemi kuptuar shumë mirë Promovimin, sensibilizimin dhe bashkëpunimin ndër etnik me qytetarët e komunës sonë, këtë nuk ka nevojë askush të na tregoj ne jemi të vetëdijshëm për këtë. Ne nuk bëjmë dallime në politikat komunale të gjitha kërkesat që i kanë pasur fermerët për pajisje bujqësore ne ndaj tyre nuk kemi bërë përjashtime, vetëm a ka qenë fermer asgjë tjetër. E lusë edhe priftin që lagjja e epërme të shikojë se si mundemi ne të kemi ujë dhe gjëra tjera, pra të kujdesemi për këtë, e jo të shikojmë problemet të fragmentarizuar se pe nuk është nevoja.

**Fazli Morina** – Sa i përket kësaj teme të bashkëpunimit ndëretnik dhe ndërkulturor, në komunën tonë nuk ka kurrfarë probleme, bashkëpunimi është shumë në nivel, kontaktet janë të përhershme, hiq më larg se dje kemi filluar edhe takimet në fshatin Hoçë e Madhe, Zoqishtë besoj se pasdite edhe në lagjen e epërme. Kërkoj nga të gjithë ju anëtar të KKSB-së që të na ofroni informatat dhe çdo gjë që është negative për gjitha shoqërinë, ne ditë të caktuar nuk kemi për takime me qytetar, por dyert tona janë të hapura çdo herë. Sa i përket lokaleve të natës, falënderoj kryetarin që është duke na përkrahur dhe drejtoreshën e inspektoratit, e kemi pasur një aksion të përbashkët me inspektoriatin dhe AVU-un dhe njësinë për reagim të shpejtë edhe pse ndoshta nuk është gjetur ajo që ne e kërkojmë, por nuk do të thotë që nuk ka pasur rezultat, në këto lokale nuk pritet asgjë e mirë por vetëm vepra të ndaluara.

**Kryetari** – Ju faleminderit komandant, ne do të përqendrohemi në ato kapacitete dhe mundësit tona që i kemi dhe do të mundohemi të japim kontributin tonë të pa rezervë për këto që u diskutuan deri më tani. Besoj se edhe drejtoresha e inspektoratit do të kujdeset që për bajram të mos lejojë në komunën tonë të ndodhë prerja e kurbanit aty ku nuk e kanë vendin, kërkojmë edhe nga ju që të jepni kontributin tuaj rreth kësaj, pra të informoni qytetarët që nuk lejohet vend e pa vend të theren kurbanet. Pra me këtë po ju uroj Kurban Bajramin, festofshim edhe shumë festa tjera. Kalojmë në pikën e radhës:

#### 4. Të ndryshme.

**Kryetari** – A ka dikush të shtojë edhe diçka sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja përfundoj në ora 16.50

Procesmbajtësi  
  
 Agim Hoti

